



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Kosovës
Komisioni për Integritime Evropiane
Mbledhja nr. 9
Prishtinë, më 10. 06. 2008
Ndërtesa e Kuvendit, ora 11:00, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje ishin të pranishëm: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova, Branislav Grbić ndërsa munguan Džezair Murati dhe Sabri Hamiti.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi.

Avni Zuka-NDI, Agron Demi-GAP, Fitore Zeneli-KDI, Petrit Hysaj-OSBE, Blerim Vela-OSCE.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi, kryetare e Komisionit me këtë

RENDITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e dt. 12.05 dhe 21.05.2008 dhe raportit nga tryeza e rrumbullakët e dt. 06.05.2008,**
- 3. Dëgjim me zëvendëskryeministrin lidhur me Procesin e Instrumentit të Para Anëtarësimit (IPA),**
- 4. Të ndryshme**
 - Raportim lidhur me udhëtimin zyrtar në Bruksel.**

3. Dëgjim me zëvendëskryeministrin lidhur me Procesin e Instrumentit të Para Anëtarësimit (IPA),

Zylfije Hundozi ftoi zëvendëskryeministrin që të bëjë prezantimin lidhur me gjendjen aktuale të Instrumentit të Para-anëtarësimit.

Hajredin Kuçi shpjegoi se IPA ka për qëllim ofrimin e asistencës financiare vendeve që synojnë anëtarësim në BE dhe vendet candidate për anëtarësim në BE. Ai shtoi se nga IPA 2008 Kosova do të përfitoj 124.7 milion euro kurse Qeveria si co-financim ka dhënë 27.8 milion që totali arrin 152.5 milion euro. Gjatë vitit 2008 IPA tha do të adresoj kryesisht këto sektorë: sundimi i ligjit, reforma e administratës publike, trashëgimia kulturore dhe kthimi i personave të zhvendosur, edukimi dhe punësimi, strukturat për zhvillimin regional në Kosovë, ambient dhe energjia. Ai tha se projektet e IPA-së se vitit 2007 do të implementohen në vitin 2008, ndërsa këtë vit është tentuar ti bashkojmë projektet e vitit 2007 me ato të vitit 2008 të cilat do të fillojnë të implementohen në vitin 2009. Shtoi se menaxhimi financiar bëhet nga Komisioni Evropian. Ai tha se në këto projekte kemi involvuar ministrin, komunat dhe shoqërinë civile. Ai shtoi se Kosova përveç nevojës për asistencë teknike ka nevojë edhe për asistencë kapitale në kuptimin e infrastrukturës. Përfitues të këtyre projekteve tha janë të gjitha shtresat e shoqërisë. Për fund tha jemi angazhuar shumë në asistencë për institucionet e reja që formohen siç janë aviacioni civil dhe formimi i ministrive të reja dhe reformat për administratën publike.

Naser Rugova tha në radhë të parë është imperativ i çdo Qeverie sundimi i ligjit për të fituar statusin e shtetit kandidat në BE. Ai tha duke i ditur vështirësitë e energjetikes se Kosoves besoi që Qeveria, Agjensioni për Integritet Evropian por edhe ne duhet që të ndihmojmë në mënyrë sinergjike njëri institucion tjetrin. Për shkak se BE-ja dhe mekanizmat tjerë janë shume te prirur që të investojnë në bujqësi dhe ambient ai propozoi që Qeveria të paraqesë projekte konkrete në këto sektorë. Shembull konkret tha e kemi Rumaninë që në vitin 2005 vetëm për mbrojtjen e ambientit konkretisht mbrojtjen e lumenjve nga erozioni ka përfutur rreth 40 milion euro për një vit.

Edita Tahiri tha me qenë se integrimi në Bashkimin Evropian është një prej prioriteteve kryesore të politikës së jashtme dhe se ka nevojë për një koordinim më të madh të të gjithë mekanizmave ekzistues që kanë të bëjnë me këtë proces, a është menduar nga Qeveria të krijohet Ministria për Integritet Evropian. Lidhur me këtë tha isha në konferencën e Bankës Botërore në Tiranë dhe në bisedë me delegacionet e shteteve që janë anëtare apo janë në proces të anëtarësimit na u tha që të nxjerrim mësim nga pësimet e tyre. Kështu që tha ne duke i marrë përvojat e tyre mos ti bëjmë gabimet që ata i kanë bërë gjatë këtij procesi.

Zylfije Hundozi përkrahu deputeten Edita Tahiri dhe shtoi se në një tryezë në pyetjen që i ishte shtruar z. Neven Mimices, pse Kroacia është vonuar në anëtarësim kur në krahasim me Bullgarinë dhe Rumaninë ka qenë shumë më përpara sa i përket aspektit të

zhvillimit ekonomik. Ai tha është përgjigjur se Kroacia ka filluar procesin e integritimit në momentin kur e ka themeluar Ministrinë.

Hajredin Kuçi tha se kërkesa për prioritet politike ka qenë prioritet i Komisionit Evropian për investim në Kosovë. Tash pas shpalljes së pavarësisë tha mendojmë se perceptimi i tyre do të ndryshoi dhe do të ketë angazhim më të madh për zhvillim ekonomik. Sa i përket themelimit të Ministrisë së Integritimeve Evropiane tha jemi duke e përgatitur Ligjin për Qeverinë dhe kemi menduar që në kuadër të ligjit të parashohim edhe Ministrin për Integritime Evropiane. Por shihet një rrezik që duke tentuar të krijojmë një ministri të re mos po e humbim trendin. Ne tha kemi Agjensionin për Integritime Evropiane por duhet ti rrisim kapacitetet nëpër ministri dhe me ngritjen e kapaciteteve ta shëndërrojm në Ministri e si kohë e përshtatshme mund të jetë rreth shtatori. Ai shtoi se është bërë plani për integritime evropiane 2008-2010 dhe Plani i Veprimit për Partneritet Evropian ku ka veprime të përbashkëta dhe janë paraparë në mënyrë të detajizuar veprimet që duhet ndërmarr. Roli i Komisionit të Kuvendit tha është i pa zëvendësueshëm.

Hydajet Hyseni pyeti kur janë përcaktuar prioritetet ku është paraparë vendi i komponentës sociale. Tutje shtoi se kam përshtypjen që janë vënë si prioritete edhe disa aktivitete të cilat nuk e kanë vendin aty dhe tha druaj se do të marrin shumë përpjekje dhe investime, e efektet do të jenë ose modeste ose kontraproduktive. Mu për këtë tha po e marr çështjen e decentralizimit dhe mënyrën se si është ndërtuar çështja e decentralizimit. Ai shtoi se synimi ynë i përgjithshëm është të ndërtojmë një shoqëri multietnike kurse te ne po ndërtohen disa komuna monoetnike, jo funksionale, asimetrike dhe druaj problematike për procesin e normalizimit, stabilizimit dhe evropianizimit. Lidhur me kthimin e të zhvendosurve tha çka mund të thuhet për kategorinë e të zhvendosurve nga Bujanovci në Kosovë sepse dikush duhet të kujdeset edhe për ta.

Hajredin Kuçi tha ne kemi tentuar që të marrim pjesë në sferat sociale dhe kemi projekte për punësimin e të rinjve, për zhvillim rural dhe zhvillimin rajonal. Qëllimi i këtij instrumenti tha është që ta përgatis Kosovën për anëtarësim në BE. Të gjitha obligimet që dalin nga Pakoja e Ahtisarit dhe prioritetet që kanë të bëjnë me të do të jenë prioritetet të Komisionit Evropian ndërsa ne tha nuk mund ti ndalim ato projekte se kemi marr zotim për implementimin e tyre ndërsa sfera sociale tha do të mbetet si angazhim për ne.

Bujar Bukoshi tha se politika e dikton edhe destinimin e të gjitha mjeteve financiare. Ne me stoicizëm tha duhet të kërkojmë që të kemi sundimin e ligjit. Nëse arrijmë që në Kosovë të sundoi Ligji të gjitha këto probleme rreth decentralizimit, shoqërisë multietnike do të zbehen. Ai mori shembull Slloveninë dhe tha kurrë nuk është thirrur se është shtet multietnik por është thirrur se është shtet demokratik dhe ligjor në të cilin asnjë jo slloven s' do ta ndien veten të hendikepuar se është jo slloven. Prandaj insistoi që ne të kemi shtet në të cilin sundon rendi dhe ligji.

Zylfije Hundozi pyeti zëvendëskryeministrin se si do të ndodh reformimi gjyqësor duke e pasur parasysh edhe laramanin e madhe të ligjeve që janë të aplikueshme në Kosovë.

Hajredin Kuçi lidhur me reformimin e sistemit gjyqësor tha Komisioni Evropian ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Qeverinë, USAID-in dhe Presidentin e Kosovës në bazë të cilit do të bëhet riemërimi i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës. Me këtë riemërim tha presim përmirësim të sistemit gjyqësor por jo edhe një revolucion. Ai tha ne si Qeveri nuk kemi ingerenca të drejtpërdrejta në sistemin gjyqësor por jemi të interesuar që Kuvendi të luaj rolin e tij përmes emërimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i cili është i vetmi organ kompetent që propozon emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Hydajet Hyseni tha se s'mund ta anashkalojmë edhe një rrezik me të cilin shpesh jemi përballur. Ai njoftoi se ka qenë anëtar i Këshillit gjyqësor për një mandat ku kanë investuar shumë USAID-i, Zyra Amerikane dhe disa faktorë tjerë të rëndësishëm në drejtim të kuptimit të konceptit të drejtësisë dhe të procesit të verifikimit të gjyqësisë. Por shtoi, ai koncept që ka qenë ndërtuar është ndryshuar rrënjësisht me tekstin e Kushtetutës. Ai tha se Këshilli Gjyqësor ka qenë funksionalizuar si multietnik pa asnjë trysni. Ai shtoi se Kuvendi do të delegoj vetëm një pjesë të anëtarëve të Këshillit po aq do të delegohen nga deputete me vende të rezervuara. Ai shtroi pyetjen se çka do të ndodh me sistemin gjyqësor në funksionim sepse gjykatësit do të gjykojnë lëndë të përziera. Për fat të keq tha të njëjtën situatë e kemi edhe në komisionin zgjedhor dhe komisionin për arsim.

Zylfije Hundozi falënderoi zëvendëskryeministrin për kontributin e dhënë .

Hajredin Kuçi shprehi gatishmërinë që të jetë i pranishëm sa herë që është e nevojshme sepse këtë tha e konsideroi si një mënyrë e mbikëqyrjes parlamentare.

1. Miratimi i rendit të ditës,

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e dt. 12.05 dhe 21.05.2008 dhe raportit nga tryeza e rrumbullakët e dt. 06.05.2008,

Procesverbalet nga mbledhja e datës 12 dhe 21.05.2008 dhe raporti u miratuan pa vërejtje.

4. Të ndryshme

a) Raportim lidhur me udhëtimin zyrtar në Bruksel.

Zylfije Hundozi i njoftoi anëtarët e Komisionit se ka qenë pjesëmarrëse në konferencën e organizuar nga Presidenca Sllovene për Ballkanin perëndimor dhe integrimin e vendeve të Ballkanit perëndimorë në Bashkimin Evropian. Ajo njoftoi anëtarët e Komisionit se në

Konferencën e datës 28 maj ka dal edhe deklarata e përbashkët. Ajo njoftoi se OSBE-ja ka paraparë një vizitë për Komisionin për Integritet Evropian në Bruksel në muajin shtator dhe ka biseduar me Doris Pak lidhur me mundësin e caktimit të takimit gjatë kohës kur do të realizohet kjo vizitë.

b) Lidhur me vizitën e Komisionit për Integritet Evropian në Shqipëri

Zylfije Hundozi i njoftoi anëtarët e Komisionit se Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë Jozefina Topalli ka shprehur gatishmërinë që të takohet me anëtarët e Komisionit dhe si data të përshtatshme për realizimin e kësaj vizite janë propozuar datat 14 -16 korrik ose 21-23 korrik .

Pas diskutimeve Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Vizita e anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian në Shqipëri do të realizohet me datë 14-16 korrik 2008.

c) Njoftim rreth work-shopit në Sofje

Hydajet Hyseni njoftoi anëtarët e Komisionit se së bashku me anëtarët e Kryesisë ka marrë pjesë në një work-shop për bashkëpunim ndër-parlamentar në Sofje. Ai tha se ishte një debat i hapur, pa tensione dhe pa probleme.

d) Rreth hartimit të Planit të Punës së Komisionit

Zylfije Hundozi i njoftoi anëtarët e Komisionit se duhet të caktohet një grup punues për hartimin e planit të punës së Komisionit për muajt në vijim pasi që plani i punës ka qenë për tre muaj.

Nait Hasani tha për shkak se nuk ju kemi përmbajtur planit tremujor të punës dhe nuk i kemi realizuar të gjitha objektivat se shoh të udhës që të hartojmë prapë plan të punës.

Pas diskutimeve Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Në mbledhjen e ardhshme të caktohet si pikë e rendit të ditës diskutimi rreth planit të punës së Komisionit dhe caktimi i grupit punues.

e) Lidhur me angazhimin e ekspertit për harmonizim të legjislacionit.

Zylfije Hundozi i njoftoi anëtarët e Komisionit se përkundër kërkesës së saj UNDP ende nuk ka angazhuar asnjë ekspert për harmonizimin e legjislacionit të BE-s dhe tha se mbetet që të diskutoi prapë dhe të shoh se çka do të bëjnë në këtë drejtim.

Pas diskutimeve Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Të caktohet një takim zyrtar me shefin e UNDP-s dhe në emër të Komisionit të kërkohet angazhimi i një eksperti për të ndihmuar Komisionin në procesin e përafrimit të legjislacionit të Kosovës me atë të BE-s.

Mbledhja përfundoi në ora 12:20 min.

Procesmbajtës:
Adelina Demolli

Kryetarja e Komisionit
Zylfije Hundozi